



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.206/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., me seli në P., kundër debitorit N.T.SH C. me seli në V., duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbarim, duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., me seli në P., kundër debitorit N.T.SH C. me seli në V., kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin CP.nr.313/16, të datës 20.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e vet, KPPP.nr.1985/2024, të datës 27.03.2024, ka hapur konfliktin e kompetencës, në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, duke konsideruar se nuk kemi të bëjmë me kompetencë të Gjykatës Komerciale, por kemi të bëjmë me përmbarimin e dokumentit në lejimin e të cilit nuk ka asnjë mjet për tu shqyrtuar, dhe gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila

është objekt për vendosjen kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtri.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme, të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës del se Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit. Ndërsa kjo gjykatë, është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lënda është dërguar pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, si gjykatë kompetente për të proceduar në këtë çështje përmbartimore. Kjo gjykatë konsideron se nuk ka kompetencë për të vendosur për këtë çështje.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon në tërësi vlerësimin ligjor se kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbartimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: "Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2.: të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate."

Me qenë se nuk kemi të bëjmë me mjetet juridike në procedure përmbartimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: "Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa," ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen se mjetet e jashtëzakonshme nuk lejohen përveç kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në raste të parapara me ligj, duke u nisur nga fakti se në rastin konkret, lënda ka për objekt zbatimin e përmbartimit sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbartimore Gjykata Komerciale nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, për faktin se palët në këtë çështje përmbartimore pasi që është lejuar përmbartimi, lënda ka qenë në gjykatën themelore dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përmbartimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kalojë te përmbartuesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin

397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Mitrovicë-Vushtrri, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përmbarimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përmbarimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë gjykatat themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbarimore, atëherë kjo çështje përmbarimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Andaj, duke u bazuar në nenin 5 pika 5 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbarim është Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, në pajtim me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për gjykatat, i cili parasheh se "Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe". Prandaj për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

CN.nr.206/2024 datë 24.04.2024

Kryetari i kolegjit,  
Beshir Islami